



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0503

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Pro Medical” SH.P.K. kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit:624-25-2455-1-2-1, me 07/08/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Pro Medical” SH.P.K. me nr. 2025/0503 , e datës 18/06/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit: 624-25-2455-1-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Pro Medical” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02/04/2025, “Pro Medical” SH.P.K. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit 624-25-2455-

1-2-1.

Ndërsa me datën 30/05/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE Letamed SH.P.K. në vlerë totale të ofertës 49,860.00

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €

Me 04/06/2025, OE “Pro Medical” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18/06/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pro Medical” SH.P.K. me nr. 0503/2025 lidhur me aktivitetin Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit: 624-25-2455-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro Medical” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1 (*Katalogët me nënvizim të specifikimeve teknike*) Operatori ekonomik ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së tij me arsyetimin se në katalogët e dorëzuar mungon emri i prodhuesit. Sipas OE ankues, kjo arsye nuk është e mbështetur në dokumentacionin e tenderit, pasi Dosja e Tenderit ka kërkuar vetëm që katalogët të përfshijnë specifikimet teknike të pajisjeve të ofruara dhe që ato të jenë të nënvizuara, pa përcaktuar që emri i prodhuesit duhet të figurojë në çdo faqe të katalogut. Ankuesi thekson se ka dorëzuar faqet përkatëse të katalogëve teknikë me përshkrimet e nevojshme dhe me nënvizim të specifikimeve sipas kërkesave të tenderit. Eliminimi i tij për një kriter që nuk është paraparë qartë në dokumentacionin e tenderit, përbën shkelje të nenit 56.3 të LPP-së, i cili ndalon përjashtimin e një operatori mbi baza të papërcaktuara në dosjen e tenderit.

Pretendimi Ankimor 2 (*Llampa kirurgjikale*) OE ankues kundërshton vendimin e AK-së për eliminimin e tij në lidhje me pajisjen “llampë kirurgjikale”, duke pretenduar se modeli i ofruar prej tij përputhet plotësisht me kërkesat teknike të specifikuara në Dosjen e Tenderit. Sipas ankuesit, llampa e tij është model mobil, e pajisur me katër rrota universale, dhe si e tillë është e përshtatshme për përdorim në ambiente të QKMF-së, ashtu siç është parashikuar në qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi thekson se modeli i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë është për montim në tavan dhe nuk është lëvizës, gjë që e bën të papërshtatshëm për kushtet e përdorimit në QKMF, ku nuk ka infrastrukturë për montim të tillë.

Pretendimi Ankimor 3 (*Negatoskopi*) Ankuesi kundërshton arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga gara për pozitën “Negatoskopi”, me pretendimin se nuk ka ofruar katalog

për këtë pajisje. Sipas tij, negatoskopi është përfshirë në katalogun e dorëzuar dhe identifikimi i saj mund të bëhet në faqet përkatëse të dokumentacionit. Mosidentifikimi i kësaj pajisjeje nga ana e komisionit të vlerësimit, sipas ankuesit, ka ardhur si pasojë e një shqyrtimi të sipërfaqshëm apo të paplotë të ofertës. Në këtë kontekst, ai vlerëson se eliminimi për këtë arsye është i pabazuar dhe përbën shkelje të parimeve të vlerësimit të drejtë dhe objektiv të ofertave.

Pretendimi Ankimor 4 (*Aparati i bioskopis*) Ankuesi konteston vlerësimin e bërë nga AK në lidhje me një pajisje të ashtuquajtur “Aparat Bioskopik”, duke deklaruar se kjo pajisje nuk ekziston fare në paramasë apo në DT. Ai konsideron se referimi i AK-së ndaj një pajisjeje që nuk ka qenë pjesë e kërkesave përbën vlerësim fiktiv dhe të paarsyetuar, me qëllim eliminimin e ofertës së tij.

Pretendimi Ankimor 5 (*EKG 12-kanalëshe*) Operatori ekonomik ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga gara në lidhje me pajisjen “EKG 12-Kanalëshe”, duke theksuar se pajisja e ofertuar përmbush plotësisht kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Sipas tij, modeli i dorëzuar ka 12 kanale, përfshin lidhje me kompjuter, ruajtje të të dhënave, analizë automatike dhe softuer për menaxhimin e të dhënave, në përputhje me specifikimet. Ankuesi shton gjithashtu se referenca në DT ndaj një modeli të caktuar (brand) është vetëm ilustrative dhe nuk përbën kërkesë detyruese, ndaj eliminimi mbi këtë bazë është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet e vlerësimit të barabartë.

Pretendimi Ankimor 6 (*Defibrilatori*) Operatori ekonomik kundërshton vlerësimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me pajisjen “Defibrilator”, duke pretenduar se vendimi për eliminimin e tij është i pabazuar. Sipas tij, modeli i defibrilatorit të ofertuar është i përfshirë qartë në katalogun e dorëzuar dhe është në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Ankuesi thekson se nëse ekziston ndonjë mospërputhje e vogël grafike apo vizuale midis ilustrimeve në katalog dhe modelit real, kjo nuk përbën devijim teknik dhe nuk ndikon në funksionalitetin apo përmbushjen e kërkesave të kontratës. Për më tepër, ai thekson se pajisja e ofertuar është teknologjikisht e barasvlershme apo edhe më e avancuar, dhe për këtë arsye nuk ka bazë për eliminim. Në këtë kontekst, ankuesi vlerëson se eliminimi i tij është bërë në kundërshtim me parimet e vlerësimit të drejtë dhe objektiv, si dhe me nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/06/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0503/2025, ndërsa me datë 23/06/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0503/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Pro Medical” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0503 ka vlerësuar si në vijim:

Ankesa me numër 2025/0503 është paraqitur nga operatori ekonomik “Pro Medical” kundër Komunës së Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit për “Blerjen dhe pajisjen me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’”. OE pretendon se është eliminuar në mënyrë të padrejtë, pavarësisht se oferta e tij ka qenë më e favorshme financiarisht dhe teknikisht e përgjegjshme. Sipas ankesës, AK ka shkelur disa dispozita të Ligjit për Prokurimin Publik, përfshirë nenet mbi barazinë në trajtim, vlerësimin e ofertave dhe ekonomicitetin. Po ashtu, OE thekson se AK ka aplikuar kritere të paqarta ose jo të përcaktuara në DT, si dhe ka favorizuar operatorin fitues, ndonëse ai nuk i ka përmbushur kërkesat teknike dhe administrative. Ankesa është e mbështetur me argumente të detajuara dhe prova, dhe kërkon rivlerësim të procedurës.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES
Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “Pro Medical” kundër Komunës së Suharekës për aktivitetin e prokurimit “Blerja dhe pajisja me aparaturë të nevojshme për QKMF ‘Rexhep Kuçi’”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe provave të bashkëngjitura nga pala ankuese, eksperti paraqet sa vijon:

I. PRETENDIMET KUNDËR VENDIMIT PËR ELIMINIMIN E OFERTËS SË PRO MEDICAL

Pretendimi Ankimor 1 (*Katalogët me nënvizim të specifikimeve teknike*)
Operatori ekonomik ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së tij me arsyetimin se në katalogët e dorëzuar mungon emri i prodhuesit. Sipas OE ankues, kjo arsye nuk është e mbështetur në dokumentacionin e tenderit, pasi Dosja e Tenderit ka kërkuar vetëm që katalogët të përfshijnë specifikimet teknike të pajisjeve të ofruara dhe që ato të jenë të nënvizuara, pa përcaktuar që emri i prodhuesit duhet të figurojë në çdo faqe të katalogut. Ankuesi thekson se ka dorëzuar faqet përkatëse të katalogëve teknikë me përshkrimet e nevojshme dhe me nënvizim të specifikimeve sipas kërkesave të tenderit. Eliminimi i tij për një kriter që nuk është paraparë qartë në dokumentacionin e tenderit, përbën shkelje të nenit 56.3 të LPP-së, i cili ndalon përjashtimin e një operatori mbi baza të papërcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1
Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik ankues dhe dokumentacionit të dorëzuar në kuadër të ofertës, eksperti shqyrtues konstaton se në Dosjen e Tenderit është kërkuar dorëzimi i katalogëve me nënvizim të specifikimeve teknike, por nuk është paraparë kërkesa që emri i prodhuesit të figurojë në çdo faqe të katalogut, dhe as nuk është përcaktuar ndonjë format i detyrueshëm për mënyrën e nënvizimit. Nga shqyrtimi i katalogëve të dorëzuar nga OE ankues rezulton se:

- Janë përzgjedhur faqet përkatëse që përmbajnë specifikimet teknike për pajisjet e ofertës;
- Në disa prej faqeve vërehet nënvizim i specifikimeve përmes theksimeve vizuale, ndërsa në faqe të tjera nënvizimi mungon, por informacioni teknik është i plotë dhe i identifikueshëm.

Në mungesë të një kërkesë të saktë dhe të qartë në dokumentacionin e tenderit lidhur me përfshirjen e emrit të prodhuesit apo me formatin e nënvizimit, eliminimi i OE ankues mbi këtë bazë vlerësohet si i pajustifikuar, dhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, i cili ndalon përjashtimin e një operatori ekonomik mbi baza që nuk janë të përcaktuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin për kontratë.

Për rrjedhojë, pretendimi ankimor 1 vlerësohet si pjesërisht i bazuar.

Ndërsa mungesa e emrit të prodhuesit në çdo faqe nuk përbën shkak të vlefshëm për eliminim, mënyra jo e njëtrajtshme e nënvizimit të specifikimeve mund të ketë ndikuar në vlerësimin e ofertës. Megjithatë, në mungesë të një kërkesë të qartë ligjore për formatin e nënvizimit, vlerësimi duhet të mbështetet mbi përputhshmërinë materiale të informacionit teknik me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi	Ankimor	2 (Llampa	kirurgjikale)
------------	---------	-----------	---------------

OE ankues kundërshton vendimin e AK-së për eliminimin e tij në lidhje me pajisjen “llampë kirurgjikale”, duke pretenduar se modeli i ofruar prej tij përputhet plotësisht me kërkesat teknike të specifikuara në Dosjen e Tenderit. Sipas ankuesit, llampa e tij është model mobil, e pajisur me katër rrota universale, dhe si e tillë është e përshtatshme për përdorim në ambiente të QKMF-së, ashtu siç është parashikuar në qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi thekson se modeli i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë është për montim në tavan dhe nuk është lëvizës, gjë që e bën të papërshtatshëm për kushtet e përdorimit në QKMF, ku nuk ka infrastrukturë për montim të tillë.

Përgjigje	ndaj	Pretendimit	Ankimor	2
-----------	------	-------------	---------	---

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik ankues dhe dokumentacionit mbështetës të dorëzuar bashkë me ofertën, ekspertit shqyrtues ka analizuar përputhshmërinë e llampës kirurgjikale të ofruar me specifikimet teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit (FDT), dhe konstaton si vijon:

Në FDT është kërkuar një llampë kirurgjikale mobile, e pajisur me 4 rrota universale, sistem frenimi, strukturë të lehtë dhe të manovrueshme, si dhe karakteristika të ndriçimit si: intensiteti $\geq 120,000$ Lux, thellësia e ndriçimit ≥ 1300 mm, temperatura e dritës 3800–5000K, etj. OE ankues pretendon se ka ofruar modelin PentaLED 30 E Light nga SIMEON Medical (Itali/Gjermani), të cilin e konsideron më të avancuar sesa modeli referencë AM-500LED. Megjithatë, nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar bashkë me ofertën rezulton se:

- Nuk jepet asnjë përshkrim i sistemit të frenimit, ndonëse kjo kërkesë është përfshirë qartë në përshkrimin teknik të pajisjes në FDT.
- Nuk paraqitet informacion për madhësinë e fushës së ndriçimit, e cila sipas FDT-së duhet të jetë 160–280 mm.
- Gjithashtu, ndonëse në ankesë thuhet se pajisja është nga SIMEON Medical, në katalogun e dorëzuar figuron prodhuesi RIMSA, duke krijuar paqartësi në identifikimin e saktë të origjinës së produktit.

Në aspektin funksional dhe vizual, pajisja e ofruar përmban rrota dhe karakteristika të tjera të përputhshme me shumicën e kërkesave të FDT-së, por mungesa e qartësisë për sistemin e frenimit dhe mungesa e të dhënave për madhësinë e fushës së ndriçimit përbëjnë elemente thelbësore që nuk janë plotësuar në mënyrë të verifikueshme përmes dokumentacionit të

dorëzuar.

Bazuar në vlerësimin teknik dhe dokumentacionin përkatës, Pretendimi Ankimor 2 vlerësohet si pjesërisht i bazuar, për shkak të përputhjes së pjesshme me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi	Ankimor	3	(Negatoskopi)
------------	---------	---	---------------

Ankuesi kundërshton arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga gara për pozitën “Negatoskopi”, me pretendimin se nuk ka ofruar katalog për këtë pajisje. Sipas tij, negatoskopi është përfshirë në katalogun e dorëzuar dhe identifikimi i saj mund të bëhet në faqet përkatëse të dokumentacionit. Mosidentifikimi i kësaj pajisjeje nga ana e komisionit të vlerësimit, sipas ankuesit, ka ardhur si pasojë e një shqyrtimi të sipërfaqshëm apo të paplotë të ofertës. Në këtë kontekst, ai vlerëson se eliminimi për këtë arsye është i pabazuar dhe përbën shkelje të parimeve të vlerësimit të drejtë dhe objektiv të ofertave.

Përgjigje	ndaj	Pretendimit	Ankimor	3
-----------	------	-------------	---------	---

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik ankues dhe verifikimit të dokumentacionit të ofertës, konstatohet se pajisja “Negatoskop” është e përfshirë në katalogun e dorëzuar, përkatësisht në faqen 6 të dokumentit. Për rrjedhojë, pretendimi i OE ankues se pajisja është ofertuar dhe e dokumentuar në katalog rezulton i saktë.

Pretendimi ankimor 3 vlerësohet si i bazuar

Pretendimi	Ankimor	4	(Aparati i bioskopis)
------------	---------	---	-----------------------

Ankuesi konteston vlerësimin e bërë nga AK në lidhje me një pajisje të ashtuquajtur “Aparat Bioskopik”, duke deklaruar se kjo pajisje nuk ekziston fare në paramasë apo në DT. Ai konsideron se referimi i AK-së ndaj një pajisjeje që nuk ka qenë pjesë e kërkesave përbën vlerësim fiktiv dhe të paarsyetuar, me qëllim eliminimin e ofertës së tij.

Përgjigje	ndaj	Pretendimit	Ankimor	4
-----------	------	-------------	---------	---

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik ankues dhe të dokumentacionit përkatës të aktivitetit të prokurimit, konstatohet se në paramasën dhe në Dosjen e Tenderit nuk figuron asnjë pajisje e quajtur “Aparat Bioskopik”. Për rrjedhojë, çdo referencë nga Autoriteti Kontraktues ndaj kësaj pajisjeje gjatë vlerësimit të ofertës nuk ka mbështetje në dokumentacionin zyrtar të tenderit, dhe nuk mund të shërbejë si bazë e vlefshme për eliminimin e një operatori ekonomik.

Pretendimi ankimor 4 vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi	Ankimor	5	(EKG 12-kanalëshe)
------------	---------	---	--------------------

Operatori ekonomik ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga gara në lidhje me pajisjen “EKG 12-Kanalëshe”, duke theksuar se pajisja e ofertuar përmbush plotësisht kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Sipas tij, modeli i dorëzuar ka 12 kanale, përfshin lidhje me kompjuter, ruajtje të të dhënave, analizë automatike dhe softuer për menaxhimin e të dhënave, në përputhje me specifikimet. Ankuesi shton gjithashtu se referenca në DT ndaj një modeli të caktuar (brand) është vetëm ilustrative dhe nuk përbën kërkesë detyruese, ndaj eliminimi mbi këtë bazë është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet e vlerësimit të barabartë.

Përgjigje	ndaj	Pretendimit	Ankimor	5
-----------	------	-------------	---------	---

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankues dhe krahasimit të tij me specifikimet teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, konstatohet se pajisja e ofertuar është përfshirë në katalog dhe përmban shumicën e veçorive funksionale të kërkuara.

Megjithatë, vërehet se pajisja nuk është në përputhje të plotë me specifikimet teknike, pasi:

- Ekran i saj është me madhësi 8" dhe rezolucion 800x600, ndërkohë që në DT kërkohej ekran 10.1" me prekje dhe rezolucion 1280x800;
- Nuk dëshmohet prania e kombinimit të butonave fizikë me prekje, siç kërkohej në mënyrë të qartë në dokumentacionin e tenderit.

Duke qenë se pajisja është ofruar në katalog dhe përmbush pjesërisht kërkesat funksionale, ndërkohë që paraqet devijime të qarta në disa prej specifikimeve të rëndësishme teknike, pretendimi ankimor vlerësohet si pjesërisht i bazuar

Pretendimi	Ankimor	6 (Defibrilatori)
------------	---------	-------------------

Operatori ekonomik kundërshton vlerësimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me pajisjen "Defibrilator", duke pretenduar se vendimi për eliminimin e tij është i pabazuar. Sipas tij, modeli i defibrilatorit të ofertuar është i përfshirë qartë në katalogun e dorëzuar dhe është në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Ankuesi thekson se nëse ekziston ndonjë mospërputhje e vogël grafike apo vizuale midis ilustrimeve në katalog dhe modelit real, kjo nuk përbën devijim teknik dhe nuk ndikon në funksionalitetin apo përmbushjen e kërkesave të kontratës. Për më tepër, ai thekson se pajisja e ofertuar është teknologjikisht e barasvlershme apo edhe më e avancuar, dhe për këtë arsye nuk ka bazë për eliminim.

Në këtë kontekst, ankuesi vlerëson se eliminimi i tij është bërë në kundërshtim me parimet e vlerësimit të drejtë dhe objektiv, si dhe me nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje	ndaj	Pretendimit	Ankimor	6
-----------	------	-------------	---------	---

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të paraqitur nga OE ankues dhe analizimit të dokumentacionit teknik në katalogun e dorëzuar, rezulton se pajisja defibrilator është përfshirë në katalog dhe përshkrimi i saj përputhet në masë të konsiderueshme me kërkesat teknike të specifikuara në Dosjen e Tenderit. Modeli i ofruar nga OE përmban karakteristikat kryesore të kërkuara, si ekran me madhësi të përafërt, defibrilim manual dhe AED, kapacitet të baterisë, modalitete të monitorimit dhe parametrat kryesorë të EKG-së, SPO2, dhe opsione të tjera funksionale të përshkruara në DT. Gjithashtu, prezantohen të dhënat për energjinë e defibrilimit dhe modalitetet e përdorimit. Megjithatë, vërehet se në disa pika specifike – si përmasat e ekranit, tensionometri dhe pulseoksimetri si pjesë integrale të pajisjes, apo mënyrat e testimit dhe demonstrimit grafik – nuk është dhënë informacion i qartë ose i plotë në katalog për të vërtetuar përputhjen e drejtpërdrejtë me të gjitha kërkesat e DT-së. Prandaj, ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nr. 6 është pjesërisht i bazuar. Edhe pse pajisja është prezente në katalog dhe mbulon shumicën e specifikave, mungesa e plotësisht të disa kërkesave specifike teknike të DT-së e pengon konstatimin e përputhjes së plotë.

II. PRETENDIMET KUNDËR OE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË

Pretendimi	Ankimor	1
------------	---------	---

Ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën për kapacitet profesional, të përcaktuar në Kërkesën 8 të Dosjes së Tenderit, e cila kërkon dëshmi

për stafin e trajnuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të ofruara. Sipas ankuesit, OE i rekomanduar ka dorëzuar vetëm një certifikatë për aparatën biokimik, dhe kjo certifikatë është lëshuar në emër të një kompanie tjetër (BioLab), e jo në emër të vetë OE-së. Për pajisjet e tjera, ankuesi thekson se nuk është ofruar asnjë certifikatë trajnimi që dëshmon disponueshmërinë e stafit të trajnuar për mirëmbajtje apo përdorim profesional të tyre. Në këtë kontekst, ankuesi vlerëson se mungesa e dëshmive të kërkuara përbën mospërbushje të kriterit të kapacitetit profesional dhe, për rrjedhojë, oferta e OE-së së rekomanduar nuk është e pranueshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 1
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton sa vijon:
Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit: Sipas Fletës së Detajuar të Tenderit (nenet 9.1 dhe 9.2), Kërkesa 8 parasheh që operatori ekonomik duhet të dëshmojë disponueshmërinë e servisimit të rregullt për aparaturën e ofruar, përmes personelit të trajnuar nga prodhuesit përkatës. Eksperti shqyrtues konstaton se operatori i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikata trajnimi vetëm për pajisjet biokimike, në emër të personave Kadri Ilazi dhe Xhelal Demiri, të lëshuara nga kompania Dialab. Këto certifikata janë në emër të një kompanie tjetër (BioLab) dhe nuk shoqërohen me dëshmi shtesë që vërtetojnë se personat në fjalë janë pjesë e stafit të operatorit ose të angazhuar me kontratë për mirëmbajtjen e pajisjeve të ofertës. Për pjesën tjetër të pajisjeve të ofruara – të cilat i përkasin prodhuesve të ndryshëm, përfshirë GIMA dhe SunBright – nuk është paraqitur asnjë certifikatë trajnimi. Mungesa e certifikatave për pajisjet e tjera sipas ekspertit shqyrtues përbën mospërbushje të kërkesës së përcaktuar në Fletën e Detajuar të Tenderit. Dëshmia për vetëm një pajisje nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar kapacitetin profesional të kërkuar për të gjithë portofolin e ofertës. Në mungesë të provave të plota dhe të verifikueshme, ekspertiza teknike nuk mund të konsiderohet e mbuluar në përputhje me kriterin përkatës. Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar. Operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të plotë dhe të vlefshme përbushjen e kërkesës për kapacitet profesional në lidhje me stafin e trajnuar për mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të ofertës, sipas Kërkesës nr. 8 të Fletës së Detajuar të Tenderit.

Pretendimi Ankimor 2
Operatori ekonomik ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka përbushur kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit lidhur me aparatën biokimik, duke argumentuar se:

- Nuk është dorëzuar lista e pjesëve shpenzuese të kërkuara për këtë pajisje, përfshirë reagentët, siç është parashikuar qartë në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme;
- Nuk është ofruar asnjë dëshmi apo deklaratë që vërteton posedimin e printerit lazerik si pjesë përbërëse ose aksesor të aparatit biokimik, pavarësisht se kjo është specifikuar si kërkesë teknike në dokumentacion.

Ankuesi thekson se mungesa e këtyre elementeve përbën një devijim nga kërkesat teknike dhe duhet të konsiderohet si mos-përmbushje e detyrueshme, duke justifikuar përjashtimin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë në këtë pikë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 2

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e paraqitur nga operatori ekonomik ankues “Pro Medical” SH.P.K., si dhe dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, lidhur me pajisjen “Aparat biokimik”.

Sipas Aneksit të Specifikimeve Teknike në Dosjen e Tenderit, për këtë pajisje është kërkuar që:

- të përfshihet lista e reagentëve dhe pjesëve shpenzuese të nevojshme për funksionimin e pajisjes;
- të jetë i përfshirë printeri laserik si pajisje shoqëruese për printimin e rezultateve laboratorike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së operatorit të rekomanduar, konstatohet se:

- nuk është dorëzuar lista e pjesëve shpenzuese për aparatin e ofertuar;
- nuk është ofruar asnjë dëshmi për përfshirjen e printerit laserik, qoftë në katalog, faturë apo dokumentacion tjetër mbështetës.

Në mungesë të këtyre elementeve të kërkuara, eksperti shqyrtues vlerëson se oferta e operatorit të rekomanduar nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për këtë pozicion.

Mbështetur në sa më sipër, pretendimi ankimor nr. 2 vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi

Ankimor

3

Operatori ekonomik ankues pretendon se llampa kirurgjikale e ofertuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit. Konkretisht, ankuesi thekson se:

- Pajisja e ofertuar nga OE i rekomanduar është llampë me montim në tavan dhe nuk përmban katër rrota universale, të cilat janë kërkuar si element funksional dhe i domosdoshëm për përdorim në ambientet e QKMF-së;
- Një pajisje e tillë nuk ofron mobilitetin dhe pozicionimin e lirë të parashikuar në dokumentacionin teknik, për shkak të natyrës së saj fikse (tavanore) dhe mungesës së mundësisë për lëvizshmëri;
- Ndërsa, llampa kirurgjikale e ofertuar nga vetë ankuesi është model mobil, me strukturë të lëvizshme dhe katër rrota universale, në përputhje të plotë me kërkesat teknike;
- Eliminimi i ofertës së tij për një pajisje funksionale dhe përputhëse, ndërkohë që është pranuar një ofertë jo përputhëse, përbën trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve

ekonomikë dhe cenon parimet e barazisë dhe objektivitetit në vlerësim.

Bazuar në sa më sipër, ankuesi vlerëson se vlerësimi i ofertave nuk është kryer në mënyrë të njëtrajtshme dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, duke kërkuar që vlerësimi të rivlerësohet për këtë pozicion dhe të konstatohet mospërputhshmëria teknike e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e paraqitur nga operatori ekonomik ankues dhe dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe konstaton si vijon:

Në Aneksin 1 – Specifikimi Teknik i Dosjes së Tenderit, është kërkuar që llampa kirurgjikale të jetë e lëvizshme, e pajisur me 4 rrota universale, dhe e përshtatshme për përdorim në ambiente jashtë sallës së operacionit, si në QKMF.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga operatori i rekomanduar për kontratë, eksperti konstaton se llampa kirurgjikale e ofertuar është e prodhuesit ARI GROUP, modeli AML500 LED Operating Lamp. Nga katalogu teknik dhe deklarata CE rezulton se kjo pajisje është model për montim në tavan dhe nuk është e pajisur me rrota ose mekanizëm lëvizshmërie.

Eksperti vlerëson se llampa e ofertuar nuk përmbush kërkesat e specifikuara në Dosjen e Tenderit, pasi montimi në tavan e bën pajisjen fikse, ndërkohë që Autoriteti Kontraktues ka kërkuar pajisje mobile. Ky dallim teknik është i rëndësishëm, pasi një pajisje fikse nuk mund të zhvendoset midis hapësirave të ndryshme të QKMF-së, gjë që e bën të papërshtatshme për këtë kontekst përdorimi.

Sipas ekspertit shqyrtues, një mospërputhje e tillë përbën devijim nga kërkesat thelbësore të dokumentacionit të tenderit. Bazuar në nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, një ofertë që nuk përmbush kërkesat teknike duhet të refuzohet.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nr. 3 është i bazuar. Pajisja e ofertuar nga operatori i rekomanduar nuk përputhet me kërkesat teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit. Për pasojë, pranimi i saj bie ndesh me parimet e vlerësimit të drejtë, objektiv dhe të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi

Ankimor

4

Operatori ekonomik ankues “Pro Medical” pretendon se gjatë procesit të vlerësimit janë aplikuar standarde të dyfishta për pajisjet mjekësore të ofertës së tij krahasuar me ato të OE-së së rekomanduar për kontratë. Konkretisht, ankuesi thekson se:

- Deviacionet e vogla nga specifikimet teknike janë toleruar për OE-në e rekomanduar (për pajisje si defibrilatori, respiratori, etj.),
- Ndërsa për ofertën e tij, të njëjtat lloj devijimesh janë konsideruar si mospërputhje të pakalueshme, duke çuar në eliminim,
- Sipas tij, kjo përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së, i cili garanton trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë në garë.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 4

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të

barabartë dhe pa diskriminim gjatë gjithë procesit të vlerësimit. Kjo nënkupton se kriteret dhe standardet teknike duhet të aplikohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në garë. Deviacionet teknike që tolerohen për një operator nuk guxojnë të konsiderohen si mospërputhje të pakalueshme për një operator tjetër në të njëjtat rrethana. Çdo ndryshim në mënyrën e trajtimit të ofertave përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së dhe cenon parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme.

Në këtë kontekst, çdo devijim apo mospërputhje duhet të trajtohet me të njëjtën rigorozitet, pa favorizuar asnjë operator ekonomik mbi tjetrin.

PËRFUNDIM

Mbështetur në arsyet e lartcekura, si përgjigje ndaj secilit prej pretendimeve ankimore të paraqitura nga operatori ekonomik “Pro Medical” SH.P.K., eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Nga analiza e dokumentacionit të ofertave dhe mënyrës së vlerësimit të kryer nga Autoriteti Kontraktues ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, rezulton se procesi i vlerësimit nuk është realizuar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili kërkon që vlerësimi të bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në mënyrë të drejtë, objektive dhe të arsyetuar.

Në këtë kontekst, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar një standard të njëjtë vlerësimi për të gjithë operatorët ekonomikë, çka përbën mospërputhje me nenin 7 të LPP-së, që garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminues. Në disa raste, OE i rekomanduar për kontratë është konsideruar përmbushës edhe pse ka pasur mospërputhje me specifikimet teknike ose dokumentacion të paplotë, ndërsa për OE ankues janë aplikuar standarde më të rrepta për devijime të ngjashme, duke çuar në eliminimin e tij.

Për më tepër, oferta e operatorit ekonomik ankues, e cila ka qenë me çmim më të ulët se ajo e OE-së së rekomanduar për kontratë, nuk është trajtuar në përputhje me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, të cilat parashohin që aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në mënyrë të drejtë, të hapur, konkurruese dhe me përdorim efikas të fondeve publike.

Këto mospërputhje në standardin e vlerësimit jo vetëm që dëmtojnë parimin e barazisë dhe konkurrencës, por edhe cenojnë integritetin e përgjithshëm të procedurës së prokurimit, siç kërkohet në nenin 1.2 të LPP-së.

Për të gjitha këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se rivlerësimi i ofertave duhet të bëhet në përputhje me nenin 59 të LPP-së, duke garantuar objektivitet, barazi në trajtim dhe zbatim të drejtë të kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrës të palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull Blerja dhe pajisja me aparature te nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suhareke me numër të prokurimit 624-25-2455-1-2-1 të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veprojnë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: